**Tiranë, më 13.09.2021**

**Lënda: Informacion për mosrealizimin e kontratës së auditimit për Partinë "Shqiptare e Rindertimit ".**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.425, datë 12.07.2021, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2020 për Partinë " **Shqiptare e Rindertimit**"

Menjeherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 23.08.2021, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me partinë politike " **Shqiptare e Rindertimit**" per fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit të letrave rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në adresat që na dërgoi KQZ-ja në vazhdim.

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi letrat e dërguara rekomande u kthyen nga shërbimi postar me shpjegimin **"i panjohur".**
Për këtë parti u përdorën gjithashtu dhe komunikimet që mundëm të merrnim nga ekspertët parardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, por dhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë pergjegjes në parti por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë "**Shqiptare e Rindertimit**" nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vertetues: Letra e dërguar dhe zarfi rekomande i kthyer nga shërbimi postar.

Faleminderit për mirkuptimin!

**Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)**

**Sherife Hoxha**

Sherife Hoxha
Rr. "Islam Alla" Pall Nr 51, Zyra 9
Njesia Bashkiake Nr 10
TIRANE




KTHEHET Mod 6-10

| | |
|---|---|
| I PANJOHUR | ☐ |
| LARGUAR | ☐ |
| ADRESË E PA MJAFTUESHME | ☐ |
| KA NDRYSHUAR ADRESË | ☐ |
| OBJEKT I PAKËRKUAR | ☐ |
| REFUZUAR | ☐ |
| ADRESË E PASAKTË | ☐ |

DATA E KTHIMIT ________

RR 639 487 174 AA

Partisë Shqiptare të
Rindërtimit
(z. Ramiz Gripshi)
Rr "Kavajës" Qendra "Clasic"
TIRANE

Nr: 1005

DEFTESE 31/08/2021 08:36:11

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

| | |
|---|---|
| Objekti | Letra Leter |
| KOD-BAR | RR639487174AA |
| Derguesi | sherife hoxha |
| Marresi | ramiz grifsha |
| Vend Mberritja | TIRANA |
| Pesha | 20 gr |
| Tarifa Totale | 70 |
| Nenshkrimi: | Eranda Gorishti |

Ir 338
51,kati i 1-re,zyra 9, Tirane
ıoo.com;

Tiranë, më 29.08.2021

e procedurave të auditimit ligjor.

indërtimit.

"Shqiptare të Rindërtimit" z. Ramiz Grifsha.

Adresa e selisë: Rruga e Kavajës, Qendra "Clasic", Tiranë.

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) **nr. 425, datë 12.07.2021**, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël të rregjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia **"Shqiptare e Rindërtimit" për vitin kalendarik 2020**, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës me nr **prot 6281 datë 23.08.2021**, me Komisjonin Qendror te Zgjedhjeve (KQZ-në), objekti i misionit të auditimit eshtë: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"*. Afati i përfundimit të procesit te auditimit eshte **23 Shtator 2021.**

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda afatit të përcaktuar në kontraten e nënshkruar me KQZ-në. ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit qe merret me shërbimin kontabël për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa me shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Presim përgjigjen tuaj, (në adresën në krye të shkresës)

Faleminderit!

**Audituesi Ligjor (Ekspert Kontabël i Regjistruar)**

**Sherife Hoxha**

EKSPERT KONTABËL I REGJISTRUAR Sherife Hoxha Certifikata Nr.338 Tirane